

## **Konsultimet nacionale me shoqërinë civile mbi Iniciativën për themelimin e KOMRA-së**

**Shkup, Maqedoni  
20.11.2010.**

Bëhet fjalë për konsultimet e dyta mbi iniciativën për themelimin e KOMRA-së në Maqedoni. Konsultimet i ka organizuar Aksioni për Paqe nga Prilepi. Në takim morën pjesë 40 pjesëmarrës/e nga territori i Maqedonisë. Takimin e moderuan Gordana Duvnjak (Këshilli Koordinues për KOMRA-në, Maqedoni) dhe Boro Kitanoski (koordinatorë nacional i procesit konsultativ në Maqedoni). Karakteristikë ishte se në takim morën pjesë përfaqësuesit e gati të gjitha shoqatave më të mëdha të veteranëve nga Maqedonia, ato shqiptare dhe maqedone.

Për konsultimet raportuan mediat si: TV Kanal 5, A1 TV, Alsat-M TV, TELMA TV, Sitel TV, MRTV.

### **Sugjerimet, opinionet dhe rekomandimet e pjesëmarrësve/eve:**

**Njëra nga çështjet kryesore me të cilat duhet të merret komisioni rajonal, është ajo për personat e zhvendosur me dhunë.**

*Në tërësi e përshëndes punën e komisionit rajonal dhe të Shoqatës ZORA, pa marrë parasysh se kush do të jetë anëtarë në kryesi, komisioni apo se si do të funksionojë, me dokumentacionin e tërësishëm të shkruar, elektronike, dhe të gjitha llojet tjera të dokumentacionit, të cilin e kemi mbledhur gjatë 10 viteve të kaluara. (...) Në lidhje me personat e brendshëm të zhvendosur, dua të theksoj se kanë qenë 76.000 persona të brendshëm të zhvendosur, dhe tani pas 10 vitesh, numri i tyre ka rënë në 600 Serbë, Maqedonë dhe Romë të cilët nuk mundën të kthehen në shtëpitë e tyre. Në pjesën hyrëse (Preambulë) të Statutit kam gjetë, të zhvendosur, thotë: zhvendosja e popullatës me dhunë si shkelje e rëndë e të drejtave të njeriut, dhe si viktime janë personat të cilët në mënyrë individuale apo kolektive kanë përjetuar dëme, duke përfshirë ato mendore, fizike dhe emocionale, etj. (Jana Petruševska, Shoqata e personave përkohësisht të zhvendosur Zora, Araquinë/ Shkup, Konsultimet nacionale me shoqërinë civile Shkup, Maqedoni, 20. nëntor 2010.)*

## **Kompetenca e KOMRA-së duhet të përfshijë edhe veprat në lidhje me ngjarjet e luftës pas vitit 2001.**

*Shënimin më të veçuar e kam lidhur me pjesën e 4-të, qëllimet dhe detyrat e Komisionit, nëni 12, ku thotë se faktet do të merren parasysh prej 1. janar 1991 deri 31. dhjetor 2001. Nuk e di kush i ka caktuar datat, dhe pse janë caktuar në atë mënyrë, por dua të theksoj se në Araqinë, në vitin 2001, është vrarë një i kthyer, gjithashtu në vitin 2007, janë djegë 24 shtëpi të maqedonëve në Araqinë, janë plaçkitur rreth 50-të shtëpi, dhe janë shitur me çmim shumë më të ulët rreth 80% e shtëpive. Kjo do të thotë se në dhjetor të vitit 2001, për personat e brendshëm të zhvendosur, gjegjësisht për konfliktet rajonale në rajon ku kanë ndodhë, po flas për Araqinë, Matejçe, Lipkovë etj, në dhjetor të vitit 2001, kriza nuk kishte mbaruar. (Jana Petruševska, Shoqata e personave përkohësisht të zhvendosur Zora, Araqinë/ Shkup, Konsultimet nacionale me shoqërinë civile, Shkup, Maqedoni, 20. nëntor 2010.)*

*Çështja tjetër e cila është me rëndësi të konstatohet, është se kemi viktimat gjatë kohës së marrëveshjes së Ohrit, dhe disa viktimat tjera edhe pas marrëveshjes së Ohrit, dhe jam përkrahës i atyre të cilët janë për vërtetimin e fakteve. Edhe pse kam qenë komandant, për shumë gjëra, unë edhe në ditët e sotme nuk mund të kuptoj se përse ka filluar ai konflikt. (Ilija Nikolovski, Shoqata e veteranëve për mbrojtje dhe siguri të R. së Maqedonisë, Shkup, Konsultimet nacionale me shoqërinë civile, Shkup, Maqedoni, 20. nëntor 2010.)*

## **KOMRA nuk duhet tua kufizojë mundësinë prestarëve të shërbimit të sigurimit për të qenë anëtarë të komisionit**

*(...) personalisht dua të cekim, se te pjesa ku kufizohet mundësia që anëtarë nuk mund të jenë pjesëtarët e shërbimeve të sigurimit, mendoj se kjo është kundërthënëse, në raport me çështjen kur me rastin e selektimit të këtyre kuadrove, thuhet se duhet të kenë vlera të larta morali, dhe mendoj se këtu është bërë një e padrejtë, sepse mendoj se në këto shërbime kemi personalitete të cilët janë profesionistë, të cilët e respektojnë ligjin, atë ndërkombëtarë dhe vendor. (Strašo Gligorov, Shoqata e veteranëve Dinjiteti, Shkup, Konsultimet nacionale me shoqërinë civile, Shkup, Maqedoni, 20. nëntor 2010.)*

## **Nëse i definojmë rrethanat, atëherë KOMRA nuk i relativizon krimet e luftës**

*Do të thotë, me fjalë të tjera, nuk ka arsyetim për krimet e luftës poqese i definojmë rrethanat. Do të thotë se, nuk kemi hyrë, do të thojë, në një debat politik apo labirint, rrethanat kanë kontribuar prandaj i kemi faktet për krimet e luftës dhe shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut. Nuk ka amnestim, nuk ka rrethana, nuk ka arsyetim. Pra, nëse fokusohemi në gjeneratat e ardhshme, por të sqarohen ato të tashmet dhe të kaluarat dhe të vërtetohen faktet, mendoj se do të ndihmojë shumë që të lirohem nga barra e luftës dhe parasegjithash të fokusohemi te viktimat. (Dragi*

Zmijanac, Ambasada e Parë e fëmijëve Megjashi, Shkup, Konsultimet nacionale me shoqërinë civile, Shkup, Maqedoni, 20. nëntor 2010.)

**KOMRA mund të na ndihmojë në vërtetimin e saktë të numrit të viktimave, ashtu që të gjitha palët e konfliktit do të fitojnë trajtim institucional.**

*Këtu ka pasë dilemë, rreth asaj se kush janë viktimat e ngjarjeve në ish Jugosllavi. Me përgjegjësi të plotë, do të thoja se viktimitë është e tërë popullata e ish Jugosllavisë, e posaçërisht shtresa më e varfër e popullatës. Kanë qenë të prezantuara disa çështje tjera, lidhur me numrin e viktimave, prandaj thashë, se të gjithë jemi viktima. Njëra palë thotë se e di numrin e të vrarëve, dhe e akuzon palën tjetër, përse nuk e tregon numrin e viktimave. Garantohet, se edhe pala e tjetër i ka të gjitha të dhënat me emër, mbiemër dhe të gjitha informatat tjera, por duhet të theksohet një gjë – fatkeqësisht, edhe pas 10 vitesh, edhe pse këtu u përmend se në Maqedoni ka pasë luftë, do të thotë se kjo është një e vërtetë e pashmangshme, por që të ketë luftë dhe të luftohet, duhet të ekzistojnë dy palë. Është në rregull, nëse njëra palë e dinë numrin e viktimave, por në krahasim me palën tjetër ne i dimë me emër dhe mbiemër, me numër, por 10 vite pas përfundimit të konfliktit, njëra palë e cila ka qenë e përfshirë në konfliktin e vitit 2001, pra pala shqiptare akoma nuk e ka trajtimin institucional nga ana e shtetit. Derisa nuk do të ndodhë kjo, unë nuk di se si do të shpallen ata numra dhe ato të dhëna, dhe kujt, dhe për këtë arsye dua të apeloj që kjo marrëdhënie të rregullohet, këto takime konsultative të mos shfrytëzohen për rastet të cilat nuk do të qojnë drejt realizimit të qëllimit të komisionit, gjë që e synon komisioni. (Raim Limani, Shoqata e veteranëve të UÇK-së, Radushë, Shkup, Konsultimet nacionale me shoqërinë civile Shkup, Maqedoni, 20. nëntor 2010.)*